Kronikë

# Përplasja me armë zjarri në Vlorë me djalin e kryeplakut të Kaninës, zbardhet dëshmia e policit: Më tha hajde pak te makina dhe më nxori armën! E qëllova disa herë para se të largohej

*Report Tv ka zbardhur dëshminë e efektivit të policisë Lisien Myrtaj, i cili u arrestua pas përplasjes me armë zjarri me djalin e kryeplakut të Kaninës.*




Redaksia
30 Prill, 10:54 | Përditesimi i fundit: 30 Prill, 17:04

Report Tv ka zbardhur dëshminë e efektivit të policisë **Lisien Myrtaj**, i cili u arrestua pas përplasjes me armë zjarri me djalin e kryeplakut të Kaninës, Juxhin (Aliaj) Todi. Ishte ky i fundit që e thirri të fliste me të dhe kur u afrua, e shau dhe nxori armën për ta qëlluar, tregoi efektivi. Në dëshmi, shpjegon se diçka nuk shkoi siç duhet pasi Juxhinit iu bllokua arma kur u shkrep ndërsa Myrtaj iu kundërpërgjigj menjëherë duke e qëlluar në pjesën e poshtme.

> *"Isha poshtë pallatit kur mu afrua Juxhini me makinë tip ML. Me përplasje verbale, i kemi mbyllur muhabetet që kemi pasur. Më tha, hajde pak tek makina dhe më nxori armën, makina ishte parkuar në një cep pallati për t'iu fshehur kamerave. Kur u afrova, më nxori pistoletën që e mbushi dhe filloi duke më sharë.*


LEXO EDHE:
***Merr flakë në lëvizje makina në Novoselë, brenda ndodhej dhe një fëmijë! Ndihma e parë i jepet nga një turiste (VIDEO)***

> *Në momentin që pistoleta u shkrep, u bllokua apo shkrehu nuk kuptova mirë dhe nxora armën për vetëmbrojtje duke qëlluar nga pjesa e poshtme brenda rregullave si uniformë policie.*
>
> *Pasi u largua me vrap, Juxhini, i cili po tentonte të qëllonte dhe unë qëllova disa herë. Nuk u largova nga vendi i ngjarjes, prita patrullat e policisë që të merrnin dëshminë duke ua shpjeguar ngjarjen dhe nga ikën", tha Myrtaj.*

**Si ndodhi ngjarja**

Pasditen e djeshme në qytetin e Vlorës në lagjen '10 Korriku', Juxhino Todi, (me mbiemër të ndërruar) djali i kryeplakut të Kaninës, Astrit Aliajt i ka shpëtuar plumbave gjatë një konflikti me armë, pas sherrit për një vajzë me Lisien Myrtajn, me detyrë efektiv policie pranë repartit 'Delta'.

Makina në pronësi të kryeplakut Astrit Aliaj, përdoret nga djali i tij. Lisien Myrtaj, ndoqi me vrap 24-vjeçarin Juxhin Todi, dhe ka qëlluar disa herë në drejtim të makinë tip 'ML'. 24 vjeçari ka mundur t'u shmanget plumbave dhe ka ikur me vrap.

Policia thotë se ka gjetur 7 gëzhoja në vendin e ngjarjes, të cilat thuhet se janë qitur nga arma e zjarrit pistoletë, e efektivit. Vijojnë kërkimet për Juxhin Todin, ndërsa Myrtaj akuzohet për veprën penale "Vrasje e mbetur në tentativë".

A.M./r.k./Shqiptarja.com

TAG: atentat astrit aliaj | juxhin todi | Lisien Myrtaj | Vlore

Komento

## Komente

**Skel:** 30/04/2022 17:35

@Vlonjat Po esht shum e vertet, per nje pasqyre, u perdor shkaku per arsye te egos. "Ego" esht semundje poshter. Dhe kjo gje ka ngren shum koka dhe na ka len shum mbrapa si njerez

Përgjigju

**refugjati:** 30/04/2022 11:42

ore ju vlonjatet me gjith men e keni gjoksin me grope por me duket qe per shenjester nuk qenkeni gje prandaj mos u mburrni kot ja qe per nje femer mund te hapen varre tani o kok bosha.mjaft se u vrate te gjithe me njeri tjetrin palla njerez

Përgjigju

**Vlonjat:** 30/04/2022 14:40

Ti thua "per nje femer hapen varre". Esht nje histori e njohur "per nje pasqyr makine vdiqen 22 apo 23 veta". Por esht thjesht shkaku jo pasoja. Behen gjerat personale edhe futet egua ne mes edhe neqoftese dikush skish ndermend te vriste per shkakun qe fillon sheri, e ben per pasojat e sherit, ofendimet dhe sharjet edhe "cfar do thon bota" etj etj. Ka ndodh qe dhe jan vrar per nje parkim makine

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**A mendoni se autobusi në Lanë duhet të kthehet në instalacion?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

Sociale

Vlorë/ Rritja e biletës, qytetarët: E papërballueshme! Do të ecim në këmbë, 40 lekë bileta është shumë
29 Prill, 21:27

Kronikë

Makina përplas 5 vjeçarin në Delvinë! Shoferja dërgohet në spital në gjendje shoku
29 Prill, 19:55

Kronikë

Përplasje me armë zjarri në Vlorë, shpëton djali i kryeplakut të Kaninës! Arrestohet polici i 'Delta': Qëllova për vetëmbrojtje! Të shtënat mes të rinjve pas sherrit për një vajzë
29 Prill, 19:01

Politikë

Rama në kantierin e ndërtimit në lagjen Kume, kritika për trotuarët, thumbon Lelin: Ç'e do këtë? S'është punë e firmës, po e ish-kryetarit të Bashkisë
29 Prill, 18:31

Politikë

Në të njëjtën ditë me Ramën në Vlorë, Basha: S'e dija që është këtu sot (VIDEO)
29 Prill, 18:15

Politikë

Rama në kantierin e Aeroportit të Vlorës, inspekton punimet bashkë me Behgjet Pacollin: Vepër që do transformojë industrinë e turizmit
29 Prill, 14:45

Sociale

Kriza energjetike, rritet me 10 lekë bileta e urbanit në Vlorë, nga nesër 40 lekë
28 Prill, 14:16

Kronikë


U akuza se lejoi kultivimin e drogës në Vlorë, shpallet i pafajshëm ish-shefi i komisariatit të Himarës
Armand Xhelili
27 Prill, 19:42

Sociale

Divjaka prezanton ofertën turistike, çelet sezoni! Në Vlorë, mbërrijnë turistët e parë, kritika për ndotjen
27 Prill, 16:52

Kronikë


U kap me 110 gramë kokainë, arrestohet 40-vjeçari në Fier
27 Prill, 14:57

Kronikë

Vlorë, konflikt me pronarin e tokës se nuk iu dha banesa! 3 gra prej 2 ditë të ngujuara brenda një dyqani! Futen në grevë urie
27 Prill, 11:18

Kronikë

Do trafikonin 55 klandestinë drejt Italisë, por u mbyt gomonia, 9 vite burg për skafistin, 6 për pronarin e hotelit ku strehoheshin sirianët! Shpallen të pafajshëm 5 detarët (VIDEO)
26 Prill, 13:29



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje